

La Liga

La Liga

**La Liga
1928-1936**

**nga
Liridoni**

**redaktor
Hipi Zhdripi**

2011

Plotë 90 vite, futboll, pika kulminante, zbritje ngrite të futbollit spanjoll në përmbledhjen La Liga. Përmbledhje për sy dhe si doracak i përgatitur për tu shtypur.

Një fillim i vështirë, një sukses i zhytur në luftë qytetare

Asgjë nuk pikën nga qielli pa qenë së pari në tokë. Edhe liga e futbollit spanjoll siq e njohim sot nuk piku ashtu kotë nga qielli. Para saj që nga viti 1902 ekzistonte *Copa del Rey*. Përpos kësaj çdo provincë apo regjion i Spanjës kishte veqëse një ligë. Shembull i mirë i kësaj periudhe ishin *Campeonato de Catalunya* në Katoloni, apo edhe *Campeonato Centro* në Madrid dhe rrethinë. Me këta shembuj fillon edhe zhvillimi dhe afirmimi i shpejt i futbollit në Spanjë, dhe brenda një kohe shumë të shkurtë dualen emra të famshëm në nivel mbi regjional si *Pichichi*, *Josep Samitier* dhe para së gjithash *Ricardo Zamora*.

Nga veprimtaria amatore e futbollit në vitin 1926 u thirrë në jetë veprimtaria si profesionale e cila që në start kishte lojtar të cilët mund të siguronin bukën e gojës nga kjo veprimtari. Me afirmimin dhe popullarizimin që arriti në këtë fazë futbolli në hapsirën e Spanjës u paraqit nevoja e krijimit të një lige të skuadrave në nivel të Spanjës. Mirëpo realizimi i kësaj ishte pakësa më i vështirë se sa paramendohej nga adhuruesit e flaktë të futbollit. Tejkalimi i kundërshtimeve në mes të përfaqësuesve të ligës së Katalonisë dhe të atyre të Baskësis rrezikonte edhe ngritjen në nivel të Spanjës. Këto dy liga tashmë kishin ngritur shumë skuadra që luanin një futboll shumë më kualitativ se tjerat dhe tashmë kishin bërë emër anë e mbanë Spanjës. Por si problem tjetër jo më i vogël paraqitej edhe ana logjistike, udhëtimet për të marrë pjesë në ndeshje ndodhte të zgjasnin deri edhe në katër-pesë ditë të tëra. Kështu që u thirrë në jetë një marrëveshje sipas së cilës do të ngritej një sistem i ligës në nivel të Spanjës me dhjetë skuadra. Në këtë ligë u përfshinë gjitha skuadrat që deri në atë kohë kishin fituar *Copa del Rey* apo kishin qenë finalistë të saj.

Si pasuese e *Real Vigo Sporting*-ut, *Celta Vigo*, edhe kjo priste një vend startimi në ligën e parë. Mirëpo skuadrat e tjera e kundërshtonin këtë përshkakë se udhëtimi deri në Vigo, në një këndë të largët Spanjës ju paraqiste probleme serioze. Kështu erdhen në përfundim tek një zgjidhje tjetër të bazuar në një turnirë të vogël, në finale të të cilit fitojë *Racing Santander* kundër *Celta Vigo*-së.

Nga kjo kohë fillon edhe ngritja e mirëfillt e sistemit të ligës së parë nga skuadrat themeluese të saj, të cilat vinin nga anë të ndryshme të Spanjës. Nga Baskësia vinin pesë skuadra : *Athletic Bilbao*, *Real Unión Irún*, *Arenas de Getxo* dhe *Real Sociedad San Sebastián*, nga Kastilia dy skuadrat e Madritit: *Real Madrid* dhe *Atlético Madrid*, ndërsa futbollistët më të aftë katalanët ishin tubuar në tri skuadrat e tyre : *FC Barcelona*, *Espanyol Barcelona* dhe *CE Europa*. Nga anët tjera të largëta nga kryeqyteti i vetmi që u kalifikua ishte *Racing Santander*.

Këto skuadra ishin themeluesit e ligës e cila më vonë do të jetë si prijatore në shumë drejtime të zhvillimit të futbollit jo vetëm në Evropë por edhe në rruzullin tokësor e deri në krijimin e degëve të ndryshme ekonomike në shoqëri.

Fishkëllima që doli nga pipi i gjyqtarit më dhjetë shkurti të vitit 1929, shënon fillimin e ligës së njohur spanjolle *Primera División*. Emri i futbollistit *José Prat Ripollés*, do të hyjë si golashënuesi i parë në historin e saj. Këtë golë e shënojë në minuten e pestë të lojës, për skuadrën e tij *Partie Espanyol Barcelona* kundër skuadrës *Real Unión Irún*.

Kushtet dhe kushtëzimet që rrjedhnin nga zhvillimi ekonomik, që në fillim u lajmëruan si ndikues të mëdhenjë në zhvillimin e kësaj disipline sportive. Kështu që në start, shumë skuadra të mira e me shumë adhurues po që vinin nga anët ruale, u deshtë të dorzoheshin para ardhmërisë. Ato nuk ishin në gjendje të përballonin kërkesat në rritje. Shembull i këtyre zhvillimeve është edhe skuadra *Real Unión Irún* e cila u dorëzua më 1932 pikërisht për shkaqet e përmendura. Skuadra dominuese e këtyre viteve para luftës qytetare ishte pa mëdyshje skuadra *Athletic Bilbao* e cila ja arriti që nga tetë sasive të rrëmbejë pesë tituj. Më 1929/30 e fitoj titullin pa asnjë humbje. Dy sasive më vonë, skuadra *Real Madrid* po kështu ja arriu të marrë titullin pa asnjë humbje.

Shumica e skuadrave për trajnerë kishin trajner anglez ndër të cilët më i njohuri ishte *Frederick Pentland* trajner i skuadrës *Athletic Bilbao*. Dominimin dyvjeçarë të *Athletic Bilbao*-së, e ndalojë *Real Madrid*-i, duke paguar një çmim të lartë për huazimet e lojtarëve. Në këtë kohë ata paguan huazimet për lojtarë të njohur si *Luis Regueiro*, *Josep Samitier* dhe *Ricardo Zamora*. Shuma që paguan kapte vlerën e 150,000 pezetave spanjolle të kohës.

Befasia e parë e ligës ndodhi në sasionin 1934/35, kur skuadra jo aq e afirmuar deri në atë kohë, *Betis Sevilla*, fitoj titullin e kampionit. Ndërsa e papritura e radhës e cila shkaktoj ndërpremtjen e aktivitetit të ligës për tri sasive ishte lufta qytetare që kalpojë Spanjën më 1936.

Një për një, e bëmë "La Liga"

**Kupa e parë, por jo edhe fundit,
FC Barcelona**

Një fletushkë, në një këndë të e së cilës ndodhej kjo shpallje :
"Miku dhe partneri ynë zt. *Kans Gamper*, nga rubrika e sportit "*Sociedad Los Deportes*" dhe mjeshtri zvicëranë donë të bashkojnë disa futbollistë në

Barcelonë, e lutë çdo adhurues të këtij sporti që të vij në të egnjëteve apo të premtëve nga ora 9 deri 11 në mbrëmje në zyren e tij."

Ishte kjo shpallja e paraqitur në fletushken "Los Deportes" të datës 22 tetor 1899, ishte kjo xixa e formimit të një yllskuadre të futbollit. Me këtë shpallje ata pakë futbollistë të ekipeve të pakta që gjendeshin në Barcelonën para dy shekujve u thirrën për të formuar një skuadër në të cilën kishte vend jo vetëm për vendasit por edhe për të huajt që ndodheshin në Barcelonë e ishin adhurues të futbollit. Ky zotëri, në Spanjë kishte migruar më 1898 në moshën 22 vjeçare, dhe aty në Barcelonë kishte vendosur të formonte një skuadër futbollit dhe si do të tregon koha dhe ja kishte arritur. Gamperi ishte një lojtarë i flakët i futbollit, një sportis i dalluar në shoqërinë e tij në disa disiplina, në gara me biçikletë dhe atletikë të lehtë në nivel ndërkomtar kishte marrë medalje. Me paraqitjen e mjaftueshme të interesuarve në redaksin e sportit të kësaj gazete më 29 nëntor 1899 u vendos themelimi i Klubit Futbolistik të Barcelonës. Termi nga anglishtja Klub Futbollistik për skuadrën tregon atë ndikimin anglofil të themeluesit të klubit në të cilin mbi gjysma ishin të huajt dhe i takonin ritit protestant të fesë së krishterë.

Si president i parë i klubit u zgjodhë anglezi *Walter Wild*, ndërsa si kapiten i skuadrës themeluesi i saj *Kans Gamper*. Loja e parë në të cilën u paraqit *FC Barcelona* u zhvillua më 8 dhjetor 1899 kundër një ekipi të tubuar nga anglezët e vendosur në *Velòdrom de la Bonanova*. Këtë ndeshje *FC Barcelona* e humbi me një golë të shënuar nga lojtari i më vonëshëm i saj, anglezi *Arthur Witty* i cili gjatë kësaj kohe luante në anën e bashkëkombasve të tij, përndryshe ata nuk do plotsonin numrin e plotë të 11 lojtarëve në fushë. Sido që të jetë kënaqësia e njohur si themelues të skuadrës me emrin e popullarizuar *Foot-Ball Club Barcelona* i cili së shpejt do të merrte rregullisht pjesë në turnirin *Campeonato de Cataluña* edhe në turnirin *Copa del Rey* qarkullojnë : *Walter Wild, Lluís d'Ossó, Bartomeu Terradas, Otto Kunzle, Otto Maier, Enric Ducal, Pere Cabot, Carles Pujol, Josep Llobet, John Parsons* dhe *William Parsons*. Këtu duhet cekur se shkrimi i emrave nuk duket të jetë i saktë përshkakë, së pari vetë gjuhës spanjolle si dhe pa rregullësi e mbajtjes së regjistrave në atë kohë dhe tendencave të ndryshme të adhuruesve të sotshëm të futbollit. Kështu i njëjti person në internet haset nën disa forma të shkrimit, gjermane, angleze, spanjole e pse jo edhe në gjuhën shqipe ndodhin ngatërtime.

Nga turma e futbollistëve dhe adhuruesve të futbollit që ja kishte arrit që me një organizim pakësa më të ngritur, më 1902 të fitoi trofeun në turnirin *Copa Macaya* dhe më 1905 atë të *Campeonato de Cataluña* u arrit të formohet një skuadër e llojit pakë a shumë siq i njohim sot skuadrat e futbollit. Më 14 mars të vitit 1909 klubi luanë ndeshjet në stadiumin *Carrer Indústria*, një stadium me kapacitet prej rreth 8,000 shikuesve. Në udhëheqjen e Gamperit në vitin 1922, klubi i skuadrës ja arrin të ketë mbi 10 000 anëtarë. Ky zhvillim dhe përkahje e ritit i mundësojë skuadrës që të zhvillonte ndeshjet në stadium më të avancuar që kishte përfunduar në po atë vitë ndërtime, e që tani thirrej stadiumi *Las Cortes* dhe kishte

kapacite fillestar rreth 22 000 shikues. Një kapacitet i cili më kalimin e kohë u ngrit në 60 000 shikues.

Këto zhvillime paralajmronin ngritjen e një skuadre prapa së cilës qëndronte një klub serioz sportiv. Për ngritjen e nivelit të lojës së skuadrës, klubi angazhojë edhe golashënuesin më të mirë të kohës në Spanjë, *Paulino Alcántara* dhe më 1917 për drejtimin e punëve dhe qështjeve të klubit si menaxhues caktohet *Jack Greenwell*. Nga kjo kohë fillon edhe ndikim i klubit në lojën e skuadrës. Ndryshimet që ndodhin në klub fillojnë të reflektohen me të madhe në lojën e skuadrës. Persona që përmenden për ndikim dhe për funksione të larta në klub nga kjo kohë deri në fillimin e luftës qyteare janë *Sagi-Barba*, *Ricardo Zamora*, *Josep Samitier*, *Félix Sesúmaga* dhe *Franz Platko*.

Nga livadhet në zyra, Real Madrid

"Zhurma" e anglezve për futbollin nuk e kurseu as kryeqendren e Spanjës së fund shekullit XIX. Rrethë e përçarkë kësaj zhurme u tubuan sportist të disiplinave të ndryshme dhe formuan skuadra futbollit në mjegullen e të cilave linden edhe klubet sportive në gjirin e të cilave hynin edhe disiplina tjera të sportit, kryesisht që kishin të bënë me "sferen magjike" të quajtur top. Në fillim të kësaj mjegulle në vitin 1897 u formuan shoqëri të vogla të ashtuquajtura *Football Sky* dhe njëra ndër to nën emrin *Madrid Foot Ball Club*. Luanin me topkome nëpër livadhet e skutat përçarkë e brenda qytetit. Nga të angazhuarit në këto forma shoqërore sportive në kujtes kanë mbetur disa emra si b.f. *José de Gorostizaga*, *Manuel Mendía*, vëllëzrit *Juan* dhe *Carlos Padrós*, *Adolfo Meléndez*, *Antonio Neyra*, por edhe *Julián Palacios* nuk mund të harrohet.

Nga kjo lojë e djelmëris së qytetit, pesë vite më vonë, më 6 mars 1902 erdhë deri tek një llojë "institucionalizimi" gjegjësisht regjistrimit të shoqëris së tyre nën emrin *Madrid Foot Ball Club*. Ky regjistrim, sot merret si ditëlindja e skuadrës futbollistike me namë botërorë *Real Madrid*. Kryetar i parë i kësaj shoqërie u zgjodhë *Juan Padrós*. Lojtarët në fush dilnin me tesha sportive të bardha, çorap të zeza, dhe me një rrip në ngjyrat simbolike të Spanjës, kuq e verdhë. Trajneri i parë i skuadrës ishte britaniku, *Arthur Johnson*. Deri në janarë të vitit 1904, skuadra ishte pjesë e klubit në të cilin bënë pjesë dhe skuadra tjera si skuadra *Moderno*, *Moncloa* dhe skuadra *Amicale*. Në radhët e kësaj të fundit ndodheshin kryesisht francezë. Kështu ishte deri më 21 maj 1904, kur në Paris, në Francë, u themelua *Fédération Internationale de Football Association (FIFA)*, më pastaj skuadra e regjistruar si *Madrid F. C.* ishte përfaqësuese zyrtare e Spanjës.

Më 16 prill 1905, skuadra, për të parën herë delë si fitimtare e një turne të nivelit regjional të Spanjës, duke fituar kundë *Athletic Bilbao*-së, me rezulttat 3:0 në finale për kupën *Copa del Rey*. Pas kësaj, për katëherë radhazi e fiton këtë kupë dhe më këtë nga të tjerët merret si shembull se si mbahet kupa në duar. Deri më 1912, skuadra ndeshjet i zhvillonte në stadiume të ndryshme, nga ky vitë, klubi që e financonte dhe

ndihmonte i sigurojë edhe stadiumin e vetë në rrugën *O'Donell*.

Si duket kjo nuk ndihmoj edhe aq në përmisimin e lojës së skuadrës por më tepër klubit. Si do që të jetë kënd, skuadrës ju deshën plotë nëntë vite që të arrij të fitojë një kupë nga hera e fundit. Kështu në vitin 1917, pasi një vit më parë e huqi në finale, më në fund ja arriti të fitojë kupen e turneut *Cope del Rey*. Në këtë kohë, ylli i skuadrës si sulmues, ishte francezi *René Petit*. Mirëpo ky ishte edhe pokali i fundit deri në lartësimin zyrtar të Ligës Spanjole të Futbollit më 1928. Deri më 1928, skuadra dështoj dy herë në finale për të fitura kupën në *Real Unión de Irún*. Në anën tjetër, një dashamirës i futbollit, me ndikim kyç në zhvillimet e përgjithëshme të Spanjës, mbreti i Spanjës *Alfonso XII*, më 1920, vendosi që nëpërmjet dekreti mbretëror, kësaj skuadre të ja dhurojë titullin *Real* që në spanishtë hiq më shumë e hiq më pakë do të thotë *Mbret*, e më këtë e merr këtë klub në rradhët e veta. Tre vite më vonë, më 1923, skuadra aktivitetet e saj fillon të i zhvillojë në stadium tjetër, më të avancuar, në stadiumin *Ciudad Lineal Velodrom*. Një vit më vonë në një stadium, shumë të madh se të klubit në stadiumin *Chamartín*.

Një përpjekje që ja vlenë, Real Club Deportivo Español

Vlimi i djalëris në qendrën e Spanjës së shekullit XIX për *sferen magjike*, adhurimi i tyre që shprehej nëpër grupe të ndryshme të pa organizuar aq mirë, bërë që më 28 tetor të vitit 1900 një grupë i till të dallohet dhe në krye të tyre të zgjedhin si president *Ángel Rodríguez Ruiz*. Ishte ky një grup të rinjsh ndër të cilët kishet dhe student të Univeristeti i Barcelonës. Me këtë vendim ata ja arriten që të ishin pjesë e historis së formit, zhvillimit e të futbollit në Spanjë. Këta të rinjë me emri, *Espanyol* që në gjuhën e katalanëve ka kuptimin si *spanjishë* donin të tregonin rrënjet spanjolle të klubit.

Lindja e këtij kulbi thirret aty diku në regjistrimet zyrtare nën emrin *Sociedad Española de Fútbol*. Ky emër u morë për faktin që themeluesit e klubit vinin nga Katolonia dhe Spanja. Me kalimin e kohës, në rradhë të skuadrës u pranuan edhe të huaj e veçanërisht u dallua angazhimi i britanikëve, të cilët edhe duket të kenë strukturuar jo vetë skuadrën por edhe klubin në tërsi.

Ngjyrat e teshave me të cilat paraqiteshin në fushë themeluesit e saj, ishin e verdha pasi që ashtu ju kishte dhënë financuesi i tyre. Mirëpo më kalimin e kohës dhe rritjen e rëndësis së simboleve si dhe të kapacitetit vetëfinancues edhe kjo ndryshojë. Mbreti i Spanjës, *Alfonos XIII*, më 1912 vendosi që këtij klubi të i japë titullin *Real* dhe ta fasu në rradhet e veta. Si shenjë e kësaj, klubi mbanë edhe stemen e mbretnis së Spanjës.

Në fillim lojtarët e skuadrës *Espanyol Barcelona* ndeshjet si vendas i luanin në stadiumin e hapur në afërsi të *Sagrada Familia*. Në vitin 1923 u strehua në stadiumin e sapongritur *Estadi Sarrià* në lagjen *Sarrià*.

Triumfet e para të mëdha për *Espanyol Barcelona* filluan pas themelimit të Ligës Spanjole të Futbollit, kur më 3 shkurt 1929 fitojë

Copa del Rey në finale kundër *Real Madrid*.

**E themeluum, por s'qe e thënë të mbesim pjesë e saj,
Arenas Club de Getxo**

Getxo që shqiptohet diçka si *Getco* apo *Gexo* apo ku ta dimë si e shqiptojnë baskët, një qytet buzë oqeanit, në provincen Biskaja, tani fqinjë i kryeqytetit të kësaj province Bilbao, në fund shekullin XIX një qytet tërheqës për tregtarë dhe industrialistë nga Bilbao e Madridi dhe më gjërë. Jehona për lojën me "sferën magjike" nuk e kurseu edhe këtë anë të Spanjës. Që në vitin 1901, djalëria, kryesisht nga radhët borxheze, filloj që të lozë sipas shembujve që kishin hasur në anët tjera.

Kështu në vitin 1909, në lagjën e saj me namë, *Las Arenas*, kurorëzohet angazhimi për formimin e një skuadre për të cilën vendoset të merret vetë emri i lagjes, *Arenas Football Club*. Emër të cilin do ta bartë deri në vitin 1912 kur vendoset përfundimisht që emrit të i ngjitet edhe emri i qytetit, *Arenas Club de Getxo*. Pas shumë përpjekjeve, pas shumë peripetive, skuadra e klubit ja arrinë që më 1917 të depërtojë deri tek finalja për kupën *Copa del Rey*, mirëpo në lojë shtesë pësojë humbje kundrejt *Real Madrid*-it me rezultatat 2:1. Mirëpo, skuadra nuk u dorzua dhe dy vite më vonë, më 1919 ja arriti të depërtojë gjerë në finale dhe aty u ndeshë me *FC Barcelona*. Kësaj rradhe lojtarët e *Arenas Club de Getxo* ja arriten që më në fund që lokalitetin e tyre ta zbukuronin me një kupë. Ata korren fitore bindëse, 5:2. Dy herë radhasi pas këtij suksesi, skuadra ja arriti gjerë në finale, një herë u ndeshë me *FC Barcelona* e më pastaj me *Real Unión Irún*, por s'qe e thënë të merrte kupen në shtëpi.

Aktivitetet dhe angazhimi i klubit, bërë që *Arenas Club de Getxo* të jetë një ndër themeluesit e Ligës së Futbollit në Spanjë më 1928. Por edhe këtu skuadra u tregua si pjesmarrëse e denjë për më shumë se 7 vite, një herë duke zënë vendin e 3-të në tabelen përfundimtare të sasionit 1929/30. Fatëkeqësisht më 1935, skuadra e klubit nuk i bëri më ballë kundërshtarëve në Ligë të parë dhe u deshtë të lëshonte vend. Që nga kjo kohë asnjëherë më nuk e ka arritur të përsërit sukseset që i patë në kohën e themelimit të Ligës.

Sido që të jetë në historin e klubit mbesin të shënuara fitorja në finalen për kupën *Copa del Rey* më 1919, si dhe dy pjesëmarrjet tjera në finale.

Kjo mbetë nga koha krenarisë së ndjenjave

Sido që të jetë, përshkrimi tabelarë dhe statestikorë nëpër sasionie i rrjedhave gjatë kësaj periudhe kohore duket pakë a shumë si vijonë.

1928 / 1929

Sasionjë i parë 29/29, siq thamë filloj më 10 shkurt 1929 dhe zgjati deri më 23 qershorë të po këtij viti. Fitimtar i tij ishte skuadra *FC Barcelona*, ndërsa skuadra tjera pjesëmarrëse ishin: *Arenas Club de Getxo*; *Athletic Bilbao*; *Atlético Madrid*; *FC Barcelona*; *RCD Español*; *CE Europa*; *Racing de Santander*; *Real Madrid*; *Real Sociedad*; *Real Unión*;

| Rradhitja | Skudra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|--------------------------------|-----------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>FC Barcelona</i> | 25 | 18 | 11 | 3 | 4 | 37 | 23 | +14 |
| 2 | <i>Real Madrid</i> | 23 | 18 | 11 | 1 | 6 | 40 | 27 | +13 |
| 3 | <i>Athletic Bilbao</i> | 20 | 18 | 8 | 4 | 6 | 43 | 33 | +10 |
| 4 | <i>Real Sociedad</i> | 20 | 18 | 8 | 4 | 6 | 46 | 41 | +5 |
| 5 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 19 | 18 | 8 | 3 | 7 | 32 | 39 | -7 |
| 6 | <i>Club Atlético de Madrid</i> | 18 | 18 | 8 | 2 | 8 | 43 | 41 | +2 |
| 7 | <i>Espanyol Barcelona</i> | 18 | 18 | 7 | 4 | 7 | 32 | 38 | -6 |
| 8 | <i>Club Esportiu Europa</i> | 16 | 18 | 6 | 4 | 8 | 45 | 49 | -4 |
| 9 | <i>Real Unión de Irún</i> | 12 | 18 | 5 | 2 | 11 | 40 | 42 | -2 |
| 10 | <i>Racing de Santander</i> | 9 | 18 | 3 | 3 | 12 | 25 | 50 | -25 |

Skudra *Racing de Santander* është rikualifikuar në *La Liga* duke zhvilluar ndeshje shtesë, dhe për kundërshtar kishte skuadrën *Sevilla FC*. *Sevilla FC* nuk ja arriti të hyjë në *La Liga* përshkakë të avantazhit prej një gole që kishte arritur të shënojë *Racing de Santander* ndaj saj. Kështu që kjo bëri që të mos ketë ndryshime në listen e pjesëmarrësve në sasionin pasues.

Fitues i kupës *Copa del Rey* për sasionin 1927/28 ishte skudra e rradhitur si e shtata në tabelen përfundimtare të kampionatit, skudra *Espanyol Barcelona*. Trofeu tashmë i popullarizuar *Pichichi* për këtë sasion ju dha golashënuesit *Paco Bienzobas* të skuadrës *Real Sociedad* i cili kishte shënuar gjithësej 14 gola. Golashënues të radhitur në listë ishin dhe tre lojtarë me nga 12 gola të shënuara ishte *Luis Regueiro* nga *Real Unión Irún*, *Lafuente* nga *Athletic Bilbao* dhe *Gaspar Rubio* nga *Real Madrid*.

Nga thjeshtësia e gjërave deri tekë kupat tashmë të famshme dhe të popullarizuara e pse jo edhe fitimpruese për ekonomin, futbollistët amaterë të Spanjës ja kishin arritur që sukseset e tyre të shkruhen si dëshmi e kohës. Shumë elemente të asaj kohe, kanë mbetur në errësirë por disa nga to sot, sot ato janë futbollit. Kështu b.f. trofeu për *mbretin* e golashënuesve *Pichichi*, apo kupa *Copa del Rey*, ato janë edhe simbole të Spanjës. E kur jemi të këto lloj simbole, sot ka dy lloj trofejsh për *mbretë* të golashënuesve, trofeu i përgjithshëm i ligës, i quajtur *Pichichi* e që i dedikohet ligës Spanjolle si dhe trofeu i brendshëm, i quajtur *Trofeo Zarra*. Për trofetë dhe elemente tjera të *La Liga*-së, përmbledhja e të cilave këtu nuk do ishte interesante pa kulminacionin e tyre do flasim më vonë në një këndë të veçant të librit.

1929 / 1930

Sasioni i dytë 29/30, siq thamë nuk patë freskim përnga pjesëmarrja e skuadrave. Ai filloj më 1 dhjetor 1929 dhe zgjati deri më 30 mars 1930. Fitimtar i tij ishte skudra *Athletic Bilbao*, ndërsa skudra tjera pjesëmarrëse ishin: *Arenas Club de Getxo*; *Athletic Bilbao*; *Atlético Madrid*; *FC Barcelona*; *RCD Español*; *CE Europa*; *Racing de Santander*; *Real Madrid*; *Real Sociedad*; *Real Unión*;

| Rradhitja | Skudra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|-----------------------------|-----------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Athletic Bilbao</i> | 30 | 18 | 12 | 6 | 0 | 63 | 28 | +35 |
| 2 | <i>FC Barcelona</i> | 23 | 18 | 11 | 1 | 6 | 46 | 36 | +10 |
| 3 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 20 | 18 | 9 | 2 | 7 | 51 | 40 | +11 |
| 4 | <i>RCD Español</i> | 20 | 18 | 9 | 2 | 7 | 40 | 33 | +7 |
| 5 | <i>Real Madrid</i> | 17 | 18 | 7 | 3 | 8 | 45 | 42 | +3 |
| 6 | <i>Real Unión</i> | 17 | 18 | 6 | 5 | 7 | 48 | 52 | -4 |
| 7 | <i>Real Sociedad</i> | 14 | 18 | 5 | 4 | 9 | 34 | 37 | -3 |
| 8 | <i>Racing de Santander</i> | 14 | 18 | 7 | 0 | 11 | 32 | 58 | -26 |
| 9 | <i>CE Europa</i> | 13 | 18 | 6 | 1 | 11 | 29 | 44 | -15 |
| 10 | <i>Athletic Club Madrid</i> | 12 | 18 | 5 | 2 | 11 | 32 | 50 | -18 |

Po thuaj se në tërë pjesën e parë të sasionit, në krye të tabelës printe *FC Barcelona*, mirëpo nga mesi epërsin e saj e minimizojë dhe poziten e parë ja mori *Athletic Bilbao*, e cila edhe e mbajti deri në fund. Skudra *Athletic Club Madrid*, e cila në pjesën e parë të sasionit qëndronte në mesin e tabelës, nga fundi pësoj disa humbje të njëpasnjëshme edhe përkundër faktit që deri në fund luftojë krahas dy kandidatët *CE Europa* dhe *Racing de Santander* për deplasim nga liga nuk ja arriti të mbetet në ligë. Për sasionin pasues në ligë hyri për të parën herë skudra baske nga qyteti Vitoria, skudra *Deportivo Alavés*.

Finalist të kupës *Copa del Rey* ishte kampioni dhe i plasuari i 5-të i tabelës përfundimtare, skudra *Real Madrid*. Fitues i saj ishte *Athletic Bilbao*.

Golashënuesit më të njohur të sasionit ishin *Guillermo Gorostiza* nga *Athletic Club de Bilbao* me 20 gola të shënuara njëherit fitues i trofeut *Pichichi*, pastaj *Gaspar Rubio* nga *Real Madrid* me 19 gola dhe *Santiago Urtizberea* nga *Real Unión de Irún* me gjithësej 18 gola të shënuara.

1930 / 1931

Sasioni i tretë 30/31 u freskua me skuadrën *Deportivo Alavés* dhe filloj më 7 dhjetor 1930 dhe zgjati deri më 5 prill 1931. Fitimtar i tij ishte skudra *Athletic Bilbao*, ndërsa skudra tjera pjesëmarrëse ishin: *Arenas Club de Getxo*; *Athletic Bilbao*; *Deportivo Alavés*; *FC Barcelona*; *RCD Español*; *CE Europa*; *Racing de Santander*; *Real Madrid*; *Real Sociedad*; *Real Unión*;

Përndryshe freski kishte dhe organizimi i ligës *La Primera División de España*. Tani për të përkujdesej *RFEF*, shkurtes për federatën spanjolle të futbollit *Real Federación Española de Fútbol*.

| Rradhitja | Skudra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|-----------------------------|-----------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Athletic Bilbao</i> | 22 | 18 | 11 | 0 | 7 | 73 | 33 | +40 |
| 2 | <i>Racing de Santander</i> | 22 | 18 | 10 | 2 | 6 | 49 | 37 | +12 |
| 3 | <i>Real Sociedad</i> | 22 | 18 | 10 | 2 | 6 | 42 | 39 | +3 |
| 4 | <i>FC Barcelona</i> | 21 | 18 | 7 | 7 | 4 | 40 | 43 | -3 |
| 5 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 18 | 18 | 8 | 2 | 8 | 35 | 38 | -3 |
| 6 | <i>Real Madrid</i> | 18 | 18 | 7 | 4 | 7 | 24 | 27 | -3 |
| 7 | <i>Real Unión</i> | 16 | 18 | 6 | 4 | 8 | 41 | 45 | -4 |
| 8 | <i>Deportivo Alavés</i> | 14 | 18 | 5 | 4 | 9 | 25 | 39 | -14 |
| 9 | <i>RCD Español</i> | 14 | 18 | 6 | 2 | 10 | 32 | 45 | -13 |
| 10 | <i>CE Europa</i> | 13 | 18 | 6 | 1 | 11 | 23 | 38 | -15 |

Në këtë sasion nga liga e parë në të dytën bije skuadara *CE Europa* dhe në vend të saj hynë një skuader nga qyteti i Valenciasë që njëherit bartë edhe emrin e qytetit *FC Valencia*. *Athletic de Bilbao* sasionin e filloj me humbje, dhe tabelës pothuaj se përgjatë tërë sasionit i printe skuadra *Real Sociedad*. Mirëpo kjo skuadër, në javën e 13-të, u detyrua t'ia lëshojë udhën kampionit. Në anën tjetër si duket skuadra *CE Europa* që në javën e 10 e kishte vulosur fatin e saj, për ti lëshuar pjesëmarrjen në ligë *FC Valencias*.

Golashënuesi më i dalluar ishte *Bata* nga *Athletic Bilbao* me 27 gola, i përnga shënimet qëndronte largë nga bashkëlojtari i skuadrës së tij *Guillermo Gorostiza* që kishte shënuar plotë 17 herë. Prapa tyre qëndronte *Ángel Arocha* nga *FC Barcelona* me 16 gola të shënuara.

1931 / 1932

Sasioni i katërt 31/32 filloj më 22 nëntor 1931 dhe zgjati deri më 3 prill 1931. Fitimtar i tij ishte skuadra *Real Madrid*, ndërsa skuadra tjera pjesëmarrëse ishin: *Arenas Club de Getxo*; *Athletic Bilbao*; *FC Barcelona*; *Deportivo Alavés*; *Donostia CF*; *CE Espanyol*; *Racing de Santander*; *Union Club Irún*; *Valencia CF*;

| Rradhitja | Skudra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|-------------------------------------|-----------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Real Madrid / Madrid C.F.</i> | 28 | 18 | 10 | 8 | 0 | 37 | 15 | +22 |
| 2 | <i>Athletic Bilbao</i> | 25 | 18 | 11 | 3 | 4 | 47 | 23 | +24 |
| 3 | <i>FC Barcelona</i> | 24 | 18 | 10 | 4 | 4 | 40 | 26 | +14 |
| 4 | <i>Racing de Santander</i> | 20 | 18 | 7 | 6 | 5 | 36 | 35 | +1 |
| 5 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 17 | 18 | 7 | 3 | 8 | 35 | 42 | -7 |
| 6 | <i>RCE Español / CE Espanyol</i> | 15 | 18 | 7 | 1 | 10 | 34 | 39 | -5 |
| 7 | <i>Valencia CF</i> | 15 | 18 | 6 | 3 | 9 | 38 | 47 | -9 |
| 8 | <i>Real Sociedad / Donostia CF</i> | 14 | 18 | 7 | 0 | 11 | 38 | 35 | +3 |
| 9 | <i>Deportivo Alavés</i> | 11 | 18 | 5 | 1 | 12 | 22 | 44 | -22 |
| 10 | <i>Real Unión / Union Club Irún</i> | 11 | 18 | 4 | 3 | 11 | 24 | 45 | -21 |

Gjatë këtij sasioni, 5-së klubeve aktive ju merret e drejta e përdorimit të titullit mbretëror *Real*. Ndër këto klube që u detyruan të ndryshonin emrin ishin: *Real Sociedad* në *Donostia CF*; *RCE Español* në *CE Espanyol*; *Real Madrid* në *Madrid CF*; *Real Unión* në *Union Club Irún*.

Fitues i kupës *Copa del Rey* ishte i plasuari i dytë në tabelë, njëherit ish-kampioni, *Athletic Bilbao*. Po thuaj se gjatë tërë sasionit, *Athletico Bilbao* ja arriti që të mbrojë titullin nga kampionati i sasionit të më parshëm, mirpo nga java e 15-të, *Real Madrid*-i, ja arriti që të merr pozitën e të parit dhe atë të mbrojë deri në përfundim të kampionatit. Në anën tjetër në fund të tabelës mbeti *Real Unión Irún* dhe u zhytë në ligën e dytë të Spanjës, nga e cila për sasionin 32/33 u përgatit të hynte skuadra *Betis Sevilla*.

Golashënuesi më i mirë i sasionit ishte *Guillermo Gorostiza* nga *Athletic Bilbao* me 12 gola të shënuara, pas tij vinte bashkëlojtari i skuadrës së tij, *Bata* me një golë të shënuar më pakë. Në pozitën e tretë *Cholin*-i nga skuadra *Donostia CF* me 10 gola sa kishte dhe *Cisco* nga *Racing de Santander*.

1932 / 1933

Sasioni i pestë 32/33 u freskua me skuadrën *Betis Sevilla* dhe filloj më 27 nëntor 1932 dhe zgjati deri më 28 mars 1933. Fitimtar i tij ishte skuadra *Real Madrid C.F.*, ndërsa skuadra tjera pjesëmarrëse ishin: *Arenas Club de Getxo*; *Athletic Bilbao*; *FC Barcelona*; *Betis Sevilla / Betis Balompié*; *Deportivo Alavés*; *Donostia CF*; *CE Espanyol*; *Racing de Santander*; *Valencia CF*;

| Rradhitja | Skuadra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|-----------------------------|------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Real Madrid C.F.</i> | 28 | 18 | 13 | 2 | 3 | 49 | 17 | +32 |
| 2 | <i>Athletic Bilbao</i> | 26 | 18 | 13 | 0 | 5 | 63 | 30 | +33 |
| 3 | <i>RCD Espanyol</i> | 22 | 18 | 10 | 2 | 6 | 33 | 30 | +3 |
| 4 | <i>FC Barcelona</i> | 19 | 18 | 7 | 5 | 6 | 42 | 34 | +8 |
| 5 | <i>Betis Balompié</i> | 17 | 18 | 6 | 5 | 7 | 31 | 45 | -14 |
| 6 | <i>Real Sociedad</i> | 15 | 18 | 6 | 3 | 9 | 41 | 47 | -6 |
| 7 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 14 | 18 | 5 | 4 | 9 | 39 | 44 | -5 |
| 8 | <i>Racing de Santander</i> | 14 | 18 | 6 | 2 | 10 | 47 | 58 | -11 |
| 9 | <i>Valencia CF</i> | 13 | 18 | 4 | 5 | 9 | 34 | 53 | -19 |
| 10 | <i>Deportivo Alavés</i> | 12 | 18 | 5 | 2 | 11 | 21 | 42 | -21 |

Në 9-të javët e para beteja për vendin e parë u zhvillua mes *Athletic de Bilbao*-së dhe *CD Espanol*-it, mirëpo nga java e 10-të e deri në përfundim të kampionatit vendin e parë e zë *Real Madrid*-i. Në pjesën e poshtme të tabelës pothuaj se gjatë tërë sasionit qëndronte skuadra *CD Alavés*.

Fitues i radhës, i kupës *Copa del Rey*, ishte i plasuari i dytë në tabelën përfundimtare, skuadra *Athletic Bilbao*. Siq u bë e ditur më lartë, nga Liga e parë u përshëndë skuadra *CD Alavés* ndërsa për sasionin e

ardhëshëm u përgatit të hyjë *Real Oviedo*.

Golashënuesi më i dalluar i sasionit ishte lojtari i skuadrës fituese të kampionatit, *Manuel Olivares* me 16 shënime. Bata nga skuadra *Athletic Bilbao* edhe këtë sasion u dallua me 15 shënime të tij. Pas tij në listën e golashënuesve më të mirë u plasua *José Iraragorri* bashkëlojtarë i *Bata-së*, por me një shënim më pakë.

Lojtarë të dalluar të skuadrës fituese të sasionit, pra të *Real Madrid-it*, ishin : *Ciriaco Errasti, Eugenio, Manuel Gurruchaga, Hilario, Luis Olaso, Luis Regueiro, Leóncito, Manuel Olivares, Pedro Regueiro, Jacinto Quincoces, Ricardo Zamora, Luis Valle*.

1933 / 1934

Sasioni i gjashtë 33/34 filloj pa skuadrën *Deportivo Alavés* në vend të së cilës, në ligë u paraqitë *Real Oviedo*. Sasioni filloj më 5 nëntor 1933 dhe zgjati deri më 4 mars 1934. Fitimtar i tij ishte skuadra, tashmë për të tretën herë, *Athletic Bilbao*. Skuadra tjera pjesëmarrëse ishin: *Arenas Club de Getxo; FC Barcelona; Betis Balompíe ; Donostia CF ; CE Espanyol ; Madrid CF ; Oviedo CF ; Racing de Santander ; Valencia CF ;*

| Rradhitja | Skuadra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|-----------------------------|------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Athletic Bilbao</i> | 24 | 18 | 11 | 2 | 5 | 61 | 27 | +34 |
| 2 | <i>Real Madrid C.F.</i> | 22 | 18 | 10 | 2 | 6 | 41 | 29 | +12 |
| 3 | <i>Racing de Santander</i> | 19 | 18 | 9 | 1 | 8 | 38 | 39 | -1 |
| 4 | <i>Betis Balompíe</i> | 19 | 18 | 9 | 1 | 8 | 29 | 36 | -7 |
| 5 | <i>Real Sociedad</i> | 18 | 18 | 7 | 4 | 7 | 29 | 33 | -4 |
| 6 | <i>Oviedo CF</i> | 18 | 18 | 8 | 2 | 8 | 51 | 45 | +6 |
| 7 | <i>Valencia CF</i> | 17 | 18 | 7 | 3 | 8 | 28 | 38 | -10 |
| 8 | <i>RCD Espanyol</i> | 17 | 18 | 7 | 3 | 8 | 41 | 42 | -1 |
| 9 | <i>FC Barcelona</i> | 16 | 18 | 8 | 0 | 10 | 42 | 40 | +2 |
| 10 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 10 | 18 | 3 | 4 | 11 | 18 | 49 | -31 |

I sapo hyri në ligë në këtë sasion, *Real Oviedo*, ja arriti të dëshmojë që e ka merituar këtë, duke e mbyllur sasionin në pozitën e 6-të të tabelës. Kupa *Copa del Rey* për këtë sasion ra në duar të skuadrës nga Madridi, *Real Madrid* e cila e mbylli sasionin në pozitën e 2-të të tabelës. Fituesi i sasionit, *Athletic de Bilbao* deri në javën e 11-të, luftonte për pozitën e parë, nga kjo javë ja arriti që për 8 javë me radhë, deri në fund të sasionit të mbajë pozitën e parë. Gjatë këtij sasioni në pjesën e poshtme të tabelës qëndronin *FC Barcelona* dhe *Arenas de Getxo* e cila që nga java e 8-të e vulosi fatin e vetë.

Golashënuesi më i dalluar i sasionit vinte nga rradhët e skuadrës *Real Oviedo*, lojtari *Isidro Lángara* me 27 gola të shënuara. Pas tij në listën e golashënuesve u rradhit *Rafa Iriondo* nga *Espanyol Barcelona* me 18 gola të shënuara, dhe pas tyre Bata nga *Athletic Bilbao* i cili kësaj rradhe u deshë të kënaqej me 15 golat e shënuara për skuadrën e vetë.

Lojtarë të dalluar të skuadrës fituese të sasionit, pra të *Athletic Bilbao*-së, ishin : *Bata, Gregorio Blasco Sánchez, José Maria Castellanos Ledo, Chirri, Leonardo Cilaurren, Juan Garizurrieta, Gerardo Bilbao, Guillermo Gorostiza, José Iraragorri, Ramón de la Fuente, José Muguerza, Roberto Echevarría Arruli*. Trajnerë i tyre ishte *Patricio Caicedo*.

1934 / 1935

Sasioni i shtatë 34/35 u deshë të nisej pa skuadrën *Arenas Club de Getxo* mirëpo numri i skuadrave pjesëmarrëse u rritë dhe për dy skuadra. Mirëpo si duket ky sasion më në fund ishte i fundit në historin e këtij klubi. Filloj më 2 dhjetor 1934 dhe përfundojë më 28 prill 1935. Fitimtar i tij ishte skuadra që para dy viteve ja kishte arritur të futet në Ligën e parë, skuadra *Betis Balompié* e njohur sipas disa adhuruesve të tjerë të saj edhe si *Betis Sevilla*. Skuadra tjera pjesëmarrëse ishin dhe : *Arenas Club de Getxo ; Athletic Bilbao ; Athletic Club de Madrid; FC Barcelona; Donostia CF ; CE Espanyol ; Madrid CF; Oviedo CF ; Racing de Santander ; Sevilla FC ; Valencia CF ;*

| Rradhitja | Skuadra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|-----------------------------|------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Betis Balompié</i> | 34 | 22 | 15 | 4 | 3 | 43 | 19 | +22 |
| 2 | <i>Real Madrid C.F.</i> | 33 | 22 | 16 | 1 | 5 | 61 | 34 | +27 |
| 3 | <i>Oviedo CF</i> | 26 | 22 | 12 | 2 | 8 | 60 | 47 | +13 |
| 4 | <i>Athletic Bilbao</i> | 25 | 22 | 11 | 3 | 8 | 60 | 37 | +23 |
| 5 | <i>Sevilla FC</i> | 24 | 22 | 11 | 2 | 9 | 53 | 38 | +15 |
| 6 | <i>FC Barcelona</i> | 24 | 22 | 9 | 6 | 7 | 55 | 44 | +11 |
| 7 | <i>Atlético Madrid</i> | 21 | 22 | 8 | 5 | 9 | 40 | 45 | -5 |
| 8 | <i>RCD Espanyol</i> | 20 | 22 | 9 | 2 | 11 | 47 | 59 | -12 |
| 9 | <i>Valencia CF</i> | 20 | 22 | 9 | 2 | 11 | 40 | 49 | -9 |
| 10 | <i>Racing de Santander</i> | 17 | 22 | 7 | 3 | 12 | 37 | 46 | -9 |
| 11 | <i>Real Sociedad</i> | 11 | 22 | 5 | 1 | 16 | 28 | 67 | -39 |
| 12 | <i>Arenas Club de Getxo</i> | 9 | 22 | 3 | 3 | 16 | 17 | 56 | -39 |

1935 / 1936

Sasioni i tetë 35/36 filloj më 10 nëntor 1935 dhe zgjati deri më 19 prill 1936. Ishte sasioni i fundit para luftës qytetare që e kaplojë Spanjën e, që e pamundësojë zhvillimin e aktiviteteve sportive. Edhe në këtë sasion moren pjesë 12 skuadra. Fitimtar i tij ishte skuadra *Athletic Bilbao* , ndërsa skuadra tjera pjesëmarrëse ishin: *Athletic Club de Madrid; FC Barcelona; Betis Balompié ; CE Espanyol; Hércules CF; Madrid CF ; Osasuna ; Oviedo CF; Racing de Santander ; Sevilla FC; Valencia CF .*

| Rradhitja | Skudra | Pikë | Nd. | N+ | N= | N- | G+ | G- | G+/- |
|-----------|----------------------------|-----------|-----|----|----|----|----|----|------|
| 1 | <i>Athletic Bilbao</i> | 31 | 22 | 14 | 3 | 5 | 59 | 33 | +26 |
| 2 | <i>Real Madrid C.F.</i> | 29 | 22 | 13 | 3 | 6 | 62 | 35 | +27 |
| 3 | <i>Oviedo CF</i> | 28 | 22 | 12 | 4 | 6 | 63 | 47 | +16 |
| 4 | <i>Racing de Santander</i> | 27 | 22 | 13 | 1 | 8 | 58 | 46 | +12 |
| 5 | <i>FC Barcelona</i> | 24 | 22 | 11 | 2 | 9 | 39 | 32 | +7 |
| 6 | <i>Hércules CF</i> | 24 | 22 | 11 | 2 | 9 | 37 | 41 | -4 |
| 7 | <i>Betis Balompié</i> | 20 | 22 | 9 | 2 | 11 | 31 | 46 | -15 |
| 8 | <i>Valencia CF</i> | 19 | 22 | 7 | 5 | 10 | 36 | 42 | -6 |
| 9 | <i>RCD Espanyol</i> | 17 | 22 | 8 | 1 | 13 | 36 | 53 | -17 |
| 10 | <i>Sevilla FC</i> | 16 | 22 | 6 | 4 | 12 | 27 | 48 | -21 |
| 11 | <i>Atlético Madrid</i> | 15 | 22 | 6 | 3 | 13 | 34 | 50 | -16 |
| 12 | <i>CA Osasuna</i> | 14 | 22 | 7 | 0 | 15 | 46 | 55 | -9 |

Article Sources and Contributors

La Liga *Source:* <http://sq.wikibooks.org/w/index.php?oldid=26056> *Contributors:* Pornoferr

Image Sources, Licenses and Contributors

File:Los culés en el Campo de la calle Industria.jpg *Source:* http://sq.wikibooks.org/w/index.php?title=Skeda:Los_culés_en_el_Campo_de_la_calle_Industria.jpg *License:* Creative Commons Attribution-Sharealike 3.0 *Contributors:* User:ManuelFD

Skeda:MFC 1905 06.jpg *Source:* http://sq.wikibooks.org/w/index.php?title=Skeda:MFC_1905_06.jpg *License:* Public Domain *Contributors:* Albertomos, Zoser, 1 anonymous edits

File:RCDE.JPG *Source:* <http://sq.wikibooks.org/w/index.php?title=Skeda:RCDE.JPG> *License:* Creative Commons Attribution 3.0 *Contributors:* User:Elemaki

Skeda:Olas remix019.jpg *Source:* http://sq.wikibooks.org/w/index.php?title=Skeda:Olas_remix019.jpg *License:* unknown *Contributors:* Pornoferr

License

Creative Commons Attribution-Share Alike 3.0 Unported
<http://creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0/>
